



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Datë: 01.08.2020

Gjakovë

KONTRATË

PËR

DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS KOMUNALE-KIOSKUN

Palët kontraktuese

- 1. Komuna e Gjakovës**, të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetar i Komunës, dhënësi i pronës komunale – Kioskut në rrugën “Ismail Qemajli” me numër të njësisë kadastrale
- 2. 1041-0** me sipërfaqe prej 6m², (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe
- 3. “Festim Delija B.I”** të cilën e përfaqëson Festim Delija, me numër personal me numër të biznesit nga Gjakova, shfrytëzues i pronës komunale - “Kioskut me numër të njësisë kadastrale 1041-0 me sipërfaqe prej 6m², (në vazhdim të tekstit: Shfrytëzuesi).

Neni 1

Baza Juridike

Baza juridike për lidhjen e kësaj kontrate është e përcaktuar në dispozitat e nenit 5, 6, 8 dhe 14 pika 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 60 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit 01.Nr.011/01-29516, datës 30.07.2019, për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale-“Kioskun”, Njoftimit Publik 01Nr.463/01-10977 i datës:29.05.2020, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale - kioskut, Rekomandimit të Komisionit Vlerësues të datës: 30.06.2020.

Neni 2

Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim afatshkurtër nga Komuna dhe marrja në shfrytëzim afatshkurtër nga Shfrytëzuesi, pronën komunale – Kioskun në rrugën “Ismail Qemajli” me sipërfaqe prej 6m², me numër të njësisë kadastrale 1041-0 zona kadastrale Gjakovë-Qytet.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shfrytëzimit

1. Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që prona komunale - kiosku sipas nenit 2 të kësaj kontrate të merret në shfrytëzim në kohëzgjatje prej 5 viteve, duke filluar nga data **01.08.2020 deri më datën 01.08.2025**.
2. Afati i shfrytëzimit nuk mund të zgjatet pa procedurë të re të njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.

Neni 4

Vlera e Kompensimit për Shfrytëzimin

Palët janë pajtuar që për shfrytëzimin e pronës komunale – Kioskut, vlera e kompensimit për periudhën e cekur në nenin 3 të kësaj kontrate, për m² është **11€**, ndërsa për shumën e përgjithshme do të jetë: **66€** në muaj (gjashtëdhjetë e gjashtë euro).

Neni 5

Mënyra dhe Afatet e Pagesës së Kompensimit

1. Palë janë pajtuar që pagesa e shumës së kompensimit nga shfrytëzuesi, për shfrytëzimin e pronës komunale - Kioskun e përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj kontrate të bëhet në fillim të çdo muaji, por jo më larg se deri më datën **05** të muajit në vijim.
2. Shfrytëzuesi i pagesës së qirasë e bënë në ditë pune në xhirollogari të Komunës së Gjakovës me destinim: pagesa e kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale – kioskut.

Neni 6

Dorëzimi i Pronës Komunale Kiosku

Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që dorëzim-pranimi i pronës komunale - Kiosku të bëhet më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga Komisioni i përcaktuar nga Komuna për lokalin afarist në prani të Shfrytëzuesit, me procesverbal. Komisioni do të emërohet me vendim të veçantë.

Neni 14

Zbatimi i kontratës

1. Për zbatimin në tërësi të kësaj kontrate do të kujdeset, Kryetari i Komunës duke e autorizuar Komisionin përgjegjës me vendim të veçantë.
2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

Hyrja në Fuqi

1. Kjo kontratë është përpiluar në katër (4) ekzemplarë autentik dhe përbënë pesë (5) faqe e cila pas leximit nga kontraktuesit është nënshkruar pa vërejtje.
2. Me kopje të kësaj kontrate përveç Qiradhënësit dhe Qiramarrësit do të njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Punë Inspektuese dhe Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe Prone.
3. Kjo kontratë hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

P A L Ë T

Komuna e Gjakovës

Ardian Gjini
Ardian Gjini



Festim Delija B.I

Festim Delija

Festim Delija